




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.04.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 293, të datës 22.03.2017, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2016

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës, për vitin 2016, në shumë të përgjithshme prej 8,172,268.75€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër kategoritë ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Për rroga dhe paga, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,405,371.98€;
 - 2.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 676,237.98€;
 - 2.3 Për shpenzime komunali, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 149,709.96€;
 - 2.4 Për subvencione dhe transfere, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 383,932.98€;
 - 2.5 Për pasuritë jofinanciare investime kapitale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 2,557,015.85€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të komunës, Drejtorisë për FB dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës
Dr.sc Fadil Krasniqi

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Direktoratë e Administratës - Regionalizim Administrativ

Nr./No. i str. 61
Data/Datum 06.04. 2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 06.04.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2017, mbështetur në kërkesën Nr. 247, të datës 14.03.2017, të Klubit të Futbollit “Fushë-Kosova”, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 223, të datës 22.03.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), nenin 48 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 52, nenin 55, të ‘Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale’, Nr. 125, të datës 25.09.2014, nenin 1, nenin 6, paragrafi 2 dhe nenin 9 paragrafi 1, pika 1.3, të ‘Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve’ Nr. 83 të datës 14.06.2013 mori:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit “Fushë-Kosova”

1. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej: 38,450.00€, për Klubin e Futbollit “Fushë-Kosova”, për t’i ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në Kampionatin e Futbollit të Ligës së Parë të Kosovës në Futboll, për sezonin pranveror të kampionatit 2016-2017 dhe sezonin vjeshtor të kampionatit 2017-2018.
2. Mjetet financiare të lejuara në pikën një (1) të vendimit në shumë të përgjithshme prej 38,450.00€, do të shpenzohen dhe destinohen për nevojat e Klubit të Futbollit “Fushë-Kosova” dhe mbarëvajtjen e garave kampionale si vijon:
 - 2.1 Mjetet financiare, në shumë prej: 7,900.00€, për shpenzimet e kuotizimit, licencimit, anëtarësinë e Klubit të Futbollit dhe transferet për seniorët, juniorët, kadetët, pionierët, fillestarët dhe parafillestarët në Federatën e Futbollit të Kosovës;
 - 2.2 Mjetet financiare, në shumë prej: 9,250.00€, për shpenzimet e zyrtarëve të ndeshjeve futbolistike;
 - 2.3 Mjetet financiare në shumë prej: 5,200.00€, për shpenzimet e mirëmbajtjes së zhveshtores dhe fushës në stadiumin e futbollit “Ekrem Graiçevci” në Fushë-Kosovë dhe shpenzimet si: rryma, uji, interneti e tjera;
 - 2.4 Mjetet financiare, në shumë prej: 6,300.00€, për shpenzimet për blerjen e pajisje sportive si: topa, këpucë, fanella, rrjeta për porta, rekuizita tjera sportive për të gjitha kategoritë e klubit;
 - 2.5 Mjetet financiare, në shumë prej: 3.300.00€, për shpenzimet e transportit për vajtje/ardhje në ndeshjet udhëtuese në transfertë të klubit;

- 2.6 Mjetet financiare, në shumë prej: 2.500.00€, për shpenzimet e ushqimit dhe pijeve freskuese;
- 2.7 Mjetet financiare, në shumë prej: 4.000.00€, për shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit jashtë vendit për përgatitjen e klubit për gara kampionale.
3. Është në kompetencë të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të sigurojë mjetet financiare sipas pikës një (1) të vendimit.
4. Obligohet Klubi i Futbollit “Fushë-Kosova” që për mjetet e lejuara financiare, sipas pikës një (1) të vendimit dhe shpërndarjes së tyre në pikën dy (2) të vendimit, t’i raportojë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Kryerja e procedurave tjera dhe mbikëqyrja e destinimit të mjeteve financiare është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc Fadil Krasniqi





REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DIREKTORIA E ADMINISTRATIVES - DIREKTORIA ZA ADMINISTRACIJE
Nr. i Aktit: 63
Data: 07-04-2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 06.04.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 222, të datës 22.03.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7 dhe nenin 27, shkronja (g), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shpalljen e znj. Vezire Gjeraku “Qytetare nderi” e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2017

1. Znj. Vezire Gjeraku, e lindur në Prishtinë në vitin 1922, me prejardhje nga fshati Sllatinë e Madhe, të Komunës së Fushë-Kosovës, u arsimua në Institutin Femëror “Nana Mbretëreshë” në Tiranë, ku punoi si mësimdhënëse. Në dhjetor të vitit 1942 e filloi punën si mësuese në Kosovë, në vendlindjen e saj në Prishtinë, në Shkollën Filllore “Hasan Prishtina, në Shkollën Filllore “Bajram Curri” në Prizren, në Shkollën Filllore të fshatit Shullaz të Krujës, në shkollat e qyteteve të Tropojës, Tiranës e Mallakastrës, organizoi mësim shtesë për zhdukjen e analfabetizmit për gratë dhe vajzat në rrethin e Krujës, shpallet “Qytetare nderi” e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2017.
2. Znj. Vezire Gjeraku, me prejardhje nga fshati Sllatinë e Madhe, ka dhënë kontributin e saj të çmuar për arsimimin e popullit shqiptar, duke filluar nga vitet e 40-ta të shekullit 20.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Palës, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRI I BEGUTËS
DREJTORIA E ARSIMIT - DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN
Miqi/Ministri: G4
Data/Gatim: 18.04.2017
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 07.04.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 301, të datës 24.03.2017, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 17, shkronja (h), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e objektit të ri të shkollës në Fushë-Kosovë

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 301, të datës 24.03.2017, për: “Dhënien e pëlqimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të ri të shkollës, paralele e ndarë e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët ‘Mihal Grameno’, te ‘Kompleksi 300’ i ndërtesave të banimit në Fushë-Kosovë, në sipërfaqe prej 1245m²”.
2. Paralelja e ndarë e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët ‘Mihal Grameno’ në Fushë Kosovë, do të jetë e tipit të mbyllur, me shtatëmbëdhjetë (17) dhoma mësimi dhe kapacitet për 1000 nxënës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës
Dr.sc Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.04.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 42, të datës 22.03.2017, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d), nenin 17, shkronja (b), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.2, nenin 10, nenin 11, nenin 16, nenin 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 (Gazeta Zyrtare Nr. 30/2013), dispozitat e Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr. 24/2015, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (b), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (b), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për fillimin e procedurave për hartimin e Hartave Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Harta Zonale e Komunës së Fushë-Kosovës, në harmoni me ligjin përkufizohet si dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për periudhën 8 (tetë) vjeçare.

Neni 3
Qëllimi i hartimit

Me Hartën Zonale të Komunës nga neni një (1) i këtij vendimi përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevoja reale dhe mundësitë për të arritur kushtet optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Fushë-Kosovës, plotëson kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonën urbane dhe rurale.

Neni 4
Kufiri i territorit

Zonat Kadastrale në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës janë:

Vendbanimet/Zonat Kadastrale	Shifra	Sipërfaqja në m²
Fushë-Kosova	P-72514036	13285932
Bardh i Madh	P-72514010	11342831
Bardh i Vogël	P-72514049	1562764
Miradi e Epërme	P-72514014	7596064
Miradi e Poshtme	P-72514027	4090759
Graboc i Poshtëm	P-72514028	8076424
Harilaç	P-72514003	7596413
Henc	P-72514031	2746751
Kuzmin	P-72514038	4334565
Lismir	P-72514022	4891070
Pomozotin	P-72514057	2745864
Sllatinë e Madhe	P-72514009	10699448
Sllatinë e Vogël	P-72514048	2554426
Vragoli	P-72514011	2801219

Neni 5
Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Hartës Zonale të Komunës caktohet Drejtoria e Planifikimit Urban.

Neni 6

Mjetet financiare dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

1. Mjetet financiare për hartimin e Hartës Zonale të Komunës sigurohen nga buxheti i Komunës së Fushë-Kosovës, Drejtoria e Planifikimit Urban koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës.
2. Harta Zonale e Komunës hartohet në bazë të kontratës të lidhur në mes të Komunës së Fushë-Kosovës dhe kontraktorit të përzgjedhur nga konkursi i projektimit përmes procedurave të prokurimit publik sipas Ligjit Nr. 03/L-241, për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor, sipas nenit (një) 1 të këtij vendimi, është i obliguar që Hartën Zonale të Komunës ta hartojë në afat prej nëntë (9) muajve, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultimet publike

Projekti i Hartës Zonale të Komunës para finalizimit duhet të vëhet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Projekt-Hartës Zonale të Komunës në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i vlefshmërisë

Harta Zonale e Komunës hartohet për periudhën kohore tetë (8) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit një (1) të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare të komunës dhe së paku në tre kopje të shtypura e të vulosura dhe tre kopje dixhitale të origjinalit.

Neni 11
Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë me nenin 11, pika 1.3, të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Me miratim nga Kuvendi Komunës së Fushë-Kosovës ky vendim hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen të komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi

